

**“MINERAL INVEST” SH.P.K.**

**PERMBLEDHJE JOTEKNIKE**

**E RAPORTIT TE**

**VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS**

*PER PAISJE ME LEJE MJEDISORE TE TIPIT B*

*(OBJEKTI I KROMIT “MAJA E GJATE 2“ TROPOJE,)*

*LEJA MINERARE NR. 232, dt 29.12.1995*

**MAJ 2015**

Lenda: Permbledhje ne gjuhe joteknike e raportit te V.N.M.-se ne objektin e kromit "Maja e Gjate 2", Tropoje

AGJENSISE KOMBETARE TE MJEDISIT  
TIRANE

P E R M B A J T J A

- 1 Permbledhje ne gjuhe joteknike e raportit te vnm-se
- 2 Pershkrim i veprimtarise, vlerave te mjedisit ne zonen e veprimtarise, ndikimeve dhe pasojave te veprimtarise ne mjedis, si dhe masave per zbutjen e pasojave ne mjedis
- 3 Pasigurite e rendesishme per veprimtarine dhe pasojat e saj ne mjedis
- 4 Procesi i vendimmarrjes dhe roli i VNM-se ne kete proces
- 5 Metodat e perqasjet per vleresimin

## 1.PERMBLEDHJE NE GJUHE JOTEKNIKE E RAPORTIT TE VNM-SE

Shoqeria "MINERAL INVEST" sh.p.k. me administrator z. Medi Çali, eshte zoterues i lejes minerare 232 dt 29.12.1995 dhene nga ana e Ministrise Ekonomise, Tregetise dhe Energjitikes, Tirane, per shfrytezimin e kromit ne objektin "Maja e Gjate 2", Tropoje j ,Qarku Kukes.

Ne kuadrin e ketij projekti synohet te jepet ne menyre te detajuar vleresimi i ndikimit ne mjedis per objektin minerar qe kerkohet te pajiset me leje mjedisore, ne te cilin pershkruhen ne menyre te hollesishme karakteristikat fizike te projektit, marrja ne konsiderate e alternativave, pershkrimi i karakteristikave te mjedisit qe mund te ndikohet, pershkrimi i ndikimeve te rendesishme te veprimtarise, parashikimi i ndikimeve indirekte, pershkrimi i masave per zbutjen e ketyre ndikimeve dhe permbajtja joteknike e projektit.

Vendburimi i kromit "Maja e Gjate" eshte i vendosur afer fshatit Zogaj ne komunen Bytyc , rrethi Tropoje, prefektura Kukes, dhe ben pjese ne planshentem topografike te shkalles 1 : 25 000 me nomeklature: K - 34 - 65 - B - a me sipersfaqe **0.01** km<sup>2</sup> dhe kufizohet nga keto koordinata :

PIKAT	Y	X
1	4443487	4686520
2	4443487	4686620
3	4443587	4686620
4	4443587	4686520

**Sipersfaqja e zones se lejuar per shfrytezim eshte 0.01 km<sup>2</sup>**

Brenda sipersfaqes se zones se kerkuar per shfrytezim dhe rreth saj nuk ka ndertesa ekzistuese ose ndonje objekt tjeter.

Relievi dallohet per karakterin e theksuar kodrinor e malor per shkalle te larte te coptimit horizontal e vertikal, pjerresine e shpateve dhe asimetrine e tyre. Kreshtat ne varesi te ndertimit gjeologjik here jane te thepisura e te ashpra, here te rrumbullakosura e te sheshta, ndersa perballe objektit ne veri, verilindje dhe jugperendim relievi paraqitet i aksidentuar deri ne trajte greminash ne zona te vecanta.

### **Perzgjedhja e menyres se shfrytezimit**

Ne zgjedhjen e sistemit te shfrytezimit jane marre parasysh keto elemente:

- Elementet e trupit te mineralit si: trashesia, kendi i renjes, pozicioni i tij lidhur me punimet e tjera te hapura.
- Qendrushmeria e mineralit dhe e shkembjeve rrethues.
- Eksperienca e fituar ne shfrytezimin e trupave te kromit ne vite ne miniere.

Duke u bazuar ne faktoret e mesiperm, minerali i kromit do te shfrytezohet me punime nentokesore

Do te perdoret sistemi me galeri nenkati

Elementet e sistemit te shfrytezimit do te jene si me poshte

- |  |             |
|--|-------------|
| • Lartesia e katit                                     | 35 - 40 ml; |
| • Lartesia e n/kateve do te jete                       | 6-8 m       |
| • Gjatesia e blloqeve (nese do te vertetohen te tille) | 40-50m      |
| • Largesia e hinkave te vjelejes se mineralit          | 6 - 8 ml;   |
| • Humbjet  | 10%         |
| • Varferimi  | 10 %.       |

Duke patur parasysh fortesine e shkembenjve nuk do te perdoret armature, me perjashtim te rasteve te vecanta si ne kryqezime punimesh apo ne zona tektonike. Ne keto raste mbajtja e tavanit do te realizohet me armature, katriazhe e kombinuar edhe me celiqe. Ne kete objekt pervec seleksionimit ne frontet e punes minerali nuk do tu nenshtrohet proceve te thyerjes, fraksionimit dhe pasurimit. Minerali i prodhuar do te destinohet direkt per eksport ose pasurim ne fabrikat me te aferta.

Duke u nisur nga rezervat e nxjerreshme qe jane 3767 ton dhe duke patur parasysh kushtet konkrete te zones qe kerkohet per leje shfrytezimi ( liçensim), ne mendojme qe prodhimtaria vjetore te jete 1000 ton/vit. Nga keto te dhena jetegjatesia e minieres parashikohet te jete 4 vjet. Numri i fronteve te punes ne shfrytezim mendohet te jete nje.

Per hapjen dhe shfrytezimin e ketij vendburimi nuk do te hapet ndonje rruge e re, pasi ajo eshte e hapur me perpara nga miniera.

Ne objekt nuk parashikohet te ndertohen objekte sociale dhe te sherbimit,mbasi ato do te i zgjidhe shoqeria ne qytetin e Bulqizes apo Krastes. Sheshet e depozitimit te sterilit dhe mineralit do te jene ne afersi te hyrjes se galerise ne nje siperfaqe prej rreth 150 m<sup>2</sup>..

## **2 PERSHKRIM I VEPRIMTARISE, VLERAVE TE MJEDISIT NE ZONEN E VEPRIMTARISE, NDIKIMEVE DHE PASOJAVE TE VEPRIMTARISE NE MJEDIS, SI DHE MASAVE PER ZBUTJEN E PASOJAVE NE MJEDIS**

### **Procesi i rrezimit..**

Rrezimi i mineralit dhe i sterilit ne kete objekt do te behet me ane te çekiçeve shpues me goditje –rrotullim me peshe relativisht te lehte dhe te njohur mjaft mire nga minaret e minieres se Batres e Bulqizes. Keto çekiçe shpojne bira me thellesi deri 3-4 m me baromine, koka e se ciles shpon vrime me diameter 38-42 mm. Numri i çekiçeve shpues do te jete gjithsej dy cope pasi aktiviteti ne kete objekt eshte i kufizuar. Fillimisht do te perdoret vetem nje çekiç shpues ne ballin e punimit te horizontit + 1200 dhe me vone do te behen dy cope (nje ne prodhim dhe nje ne punimet pergatitore dhe te shfrytezimit).

### **Procesi i ngarkimit ne front.**

Procesi i ngarkimit ne front do te behet me krahe me lopate dore. Kapaciteti i frontit per objektin eshte i kufizuar dhe perballohet me kete menyre ngarkimi.

### **Transporti i brendshem.**

Transporti i mineralit ne frontet e shfrytezimit do te behet per gravitet pasi pjerresia e trupit xeheror e lejon nje gje te tille.

Transporti i mineralit ne galerite e nenkatit do te behet me vagona te kthyeshem  $0.3 \text{ m}^3$ .

Transporti i mineralit dhe i sterilite ne galerine e transportit do te behet me vagona  $0.86 \text{ m}^3$ .

Ne varesi te sheshit te depozitimit ne siperfaqe te minieres, minerali qe do te depozitohet dhe transportohet nga atje per eksport ose pasurim. Do te ngarkohet qe aty me mjete transporti me kapacitet te madh per t'u transportuar per eksport ne Durres ose fabrikat e pasurimit.

### **Punimet e shpim-plasjes**

Fortesia e shkembinjve sic u parashtrua me larte eshte e tille qe ben te domosdoshem perdorimin e punimeve me lende plasese. Prodhimi i mineralit te kromit ne miniere eshte projektuar 2200 ton ne vit duke rezervuar te drejten e shoqerise qe ne funksion te kerkesave te tregut te argumentojne rritjen e vellimit te prodhimit deri ne shfrytezimin e tij ose ne mungese tregu uljen e tij, ne programet vjetore qe harton dhe miraton ne organet qe me ligje bejne administrimin e tyre. Menytrat e hapjes e pergatitjes se objektit per shfrytezim te pershkruara me larte sigurojne rritje prodhimi mbi ate te projektuar duke rritur numrin e fronteve te punes.

## **3 PASIGURITE E RENDESISHME PER VEPRIMTARINE DHE PASOJAT E SAJ NE MJEDIS**

Vleresimet e ndikimeve ne fazen e shfrytezimit mund te ndryshojne me ate te fazes pergatitore dhe instalimit te teknologjise, megjithate disa lloje ndikimesh, pasojat dhe receptoret e ndikimeve jane te njejte me te parat. Ky ndikim eshte i njejte nga pikpamja cilesore, por ndryshimi ne fazen e shfrytezimit qendron ne aspektin sasior te tij si p.sh. kohezgjatja e ndikimit, ekspozimi ndaj tij, vlera e ndikimit apo sinjifikanca e tij.

Identifikimi dhe vleresimi i rreziqeve te tjere per fazen e operimit dhe shfrytezimit te objektit Nisur nga natyra e veprimtarise qe kerkon perdorimin e makinerive dhe lendeve plasese dhe duke marre ne konsiderate faktore natyrore qe mund te favorizojne shfaqjen e situatave jo te zakonshme, gjate fazes se operimit mund te identifikohen edhe ndikime te tjera si:

Erozioni dhe levizja e grimcave minerale gjate transportit, qe do te thote ushtrimi i ndikimit te tyre jashte kufijve te objektit, me pasoja sidomos ne trupat ujore te zones. Erozioni do te kontrollohet permes masave te parashkuara ne Planin e Menaxhimit. Sterilet (megjithese te pakta) do te sistemohen dhe perdoren gjate rehabilitimit duke sherbyer si faze ndarese midis shkembimit dhe mases se dheut. Ne kete menyre ato sherbejne per stabilizimin dhe krijimin e agregateve strukturore te tokes, porozitetin dhe drenazhimim.

Ndikim i botes se gjalle nga veprimtaria. Megjithese objekti do te shfrytezohet me nentoke dhe kohezgjatja e parashkuar per shfrytezimin e veprimtarise eshte e shkurter, lloje te ndryshme faunistike ne objekt do te gjenden nen presion te vazhdueshem, sidomos nga zhurmat. Keto ndikime jane te pashmangshme por masat per zbutjen e tyre mund te rezultojne te sukseseshme ne fazat e ndryshme te zhvillimit te biodiversitetit, vecanerisht gjate ciklit te riprodhimit. Keto masa do te mund te zbatohen me me teper efikasitet gjate vitit te dyte te shfrytezimit mbasi te jete njohur mire sjellja e biodiversitetit ne objekt. Njekohesisht mund te ndodhe demtim habitati dhe folesh te llojeve biologjike me status te vecante mbrojtjeje

Gjate fazes se shfrytezimit nuk do te ndodhin ndryshime te pakthyeshme dhe te pashmangshme ne pejsazhin, topografine dhe gjeologjine e siperfaqes ku do te terhiqet minerali poasi sic theksuam shfrytezimi do te jete nentokesor.

Aksidente te mundshme te punonjesve gjate proceseve teknologjike ne objekt, veçanerisht gjate kryerjes se shperthimeve.

Duhet kuptuar qe probabiliteti qe secili nga skenaret e mesiperm te ndodhe do te varet shume nga masat qe do te parashikohen dhe zbatohen ne Planin e Menaxhimit.

### **Vleresimi i ndikimeve ne fazen e mbylljes se minieres**

Mbas shfrytezimit te objektit dhe mbylljes se veprimtarise eshte planifikuar te realizohen punime rehabilitimi te konceptuara ne dy faza sipas natyres se punimeve dhe qellimit te tyre.

Operacionet per rehabilitimin e hyrjes se galerive dhe shesheve te depozitimit do te realizohen,

- per largimin e makinerive,
- per sistemimin dhe pershtatjen e siperfaqes se demtuar per rehabilitim,
- per mbjelljet dhe kujdesin per rritjen e tyre

Ndikimet me te mundshme qe lidhen me kete faze jane:

- Emetime pluhurash dhe zhurmash gjate procesit te çmontimit te makinerive dhe sistemimit te sterilizimit,
- Emetime gazrash si pasoje e levizjes dhe transportit te pajisjeve,
- Derdhje aksidentale karburanti dhe hidrokarburesh nga mjetet e transportit.

Keto jane ndikime te pashmangshme plotesisht por kompania do te marre masat e duhura qe te minimizohen ne maksimum, sidomos duke planifikuar eficencen dhe ulur kohezgjatjen e realizimit te operacioneve.

Qellimi kryesor i pergatitjes se planit te masave eshte shmangia, zbutja dhe kompensimi i mundshem i ndikimeve negative me qellim qe te reduktohen ndikimet deri ne nivelet e pranuar. Per te shmangur dhe menaxhuar sa me mire ndikimet negative ne mjedis te shkaktuara nga operacionet e punes te pershkruar me siper, kompania nepermjet personelit te saj ka perpiluar dhe do te zbatoje nje plan efikas menaxhimi te ndikimit ne mjedis.

Vleresimi i sinjifikances se ndikimeve nenkupton sa e ushtron veprimtaria e propozuar ndikimin ne mjedisin natyror dhe socio-ekonomik brenda konceptit kohe dhe eshte nje nder aspektet me te rendesishme per te gjykuar mbi te. Qellimi per te cilin u vleresua sinjifikanca e ndikimeve eshte te vleresimi i veprimtarise ne menyre objektive propozimi i masave efikase per minimizimin e ndikimeve thelbesore.

Ndikimet mjedisore te minieres do te zvogelohen duke zbatuar me korrektesi teknikat e meposhtme:

- Piketim te sakte te siperfaqes se shfrytezimit dhe operim vetem brenda saj,
- Kontrolli i pluhurave permes lagjes se zones se punes dhe mbulimit te kamioneve gjate transportit,
- Kontrollin e dherave te gjeneruara dhe sistemimin e tyre me ane te kompaktimit,
- Hapjen e kanaleve te nevojshem per te drejtuar ujerat e shiut dhe erozionin,
- Perdorim te mireplanifikuar dhe te kontrolluar sipas rregullores
- Kontroll teknik i mjeteve te punes per te parandaluar rrjedhjet e karburantit

### **Rregulla te pergjithshme per sigurimin teknik dhe mbrojtjen ne pune.**

Gjate ushtrimit te ketij aktiviteti minerar, subjekti do te mbaje parasysh qe problemet e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune te jene me te rendesishmet dhe me te mprehtat, qe kerkojne vleresim serioz.

Riaktivizimi i minierave te braktisura per nje periudhe te gjate kohe , si dhe puna prane hapsirave te krijuara mbas shfrytezimit , gjithmone mbart mbi vehte rreziqe. Me shume se kudo , ne kete projekt eshte e domsdoshme , qe per drejtimin teknik te punimeve te aktivizohen specialiste te larte , me ekperience ne fushen e shfrytezimit te mineralit te kromit dhe mundesisht ta kene njohur zonen ne te cilen do te ushtrohet aktiviteti minerar.

Para se gjithash , ne te gjitha operacionet duhet te punesohen specialiste me eksperience pune ne kryerjen e proceseve te punes.

Drejtuesi teknik i punimeve , para fillimit te punes dhe gjate saj , te zbatoje me rregullesi rregullat dhe normat e percaktuar ne :

1. „Rregulloren e Teknikes se Sigurimit per Minierat dhe Karrierat te vitit 1999 te hartuar nga Instituti i Teknologjise Nxjerrrese dhe Perpunuese te Mineraleve te miratuar me urdher te Ministrit Nr. 132 , date 07.04.1999 , mbeshtetur ne nenin 17 te Ligjit Minerar Shqiptar Nr. 7796 , date 17.02.1994 dhe te botuar nga Ministria e Ekonomise Publike dhe Privatizimit ( sot Ministria e Ekonomise , Tregtise dhe Energjitikes ) , ne vitin 2001“

2. Rregullore “Mbi disa shtesa dhe ndryshime ne Rregulloren e teknikes se sigurimit per Miniera e Karriera, miratuar me urdher te Ministrit Nr. 477.prot. date 30.05.2007”.

3. „V.K.M , Nr. 533 date 08.07.2005 ” Per perdorimin civil te lendeve plasese ne Republiken e Shqiperise”.

Rregullorja e Teknikes se Sigurimit , nga ana e drejtuesit teknik te punimeve dhe subjektit te zbatohet ne çdo proces pune te percaktuar ne plan-organizimin e kryerjes se punimeve te hartuara nga ai dhe te miratuar nga drejtuesi i firmes.

Pervec sa me sipër , nisur nga kushtet reale te objektit ku do te ushtrohet aktiviteti minerar theksojme se:

Punimet gjate gjithë gjatesise se tyre duhet te kontrollohen , te zevendesohet armatimi i vjeter dhe te vendoset armatim i ri aty ku eshte e domosdoshme.

Çdo veprim te behet nen drejtimin e drejtuesit teknik me pervojë.

- A. Mbas ringritjes se punimeve dhe riazhornimeve perkatese , punimet e projektuara te hapen ne shkembinjte e dyshemese se trupit dhe hapsires , jo me afer se 15 m nga konturi i hapsires.
- B. Te gjitha ato punime qe hasin ne hapsira , te cilat jane bosh ose te mbushura , te bllokohen me mur guri per te ndaluar futjen e punetoreve ne to dhe per te siguruar levizjen e drejtuar te rrymave te ajrit te paster.
- C. Gjate periudhes se hapjes ashtu edhe gjate shfrytezimit te kontrollohet gjendja e ajrimit te pakten dy here brenda turnit nga gazmatesi.
- D. Te kontrollohet nga drejtuesi teknik dhe personeli tjeter drejtues i subjektit mbajtja e paisjeve mbrojtese individuale nga ana e punetoreve.
- E. Te organizohet sipas normave te P.E.M-it grupi avaro-shpetues.
- F. Drejtuesi teknik i subjektit te kryeje instruksione te rregullta mujore e tremujore ku te trajtoje probleme te ndryshme per te gjitha profesionet

### **3. MASAT E SIGURISE NE PUNE NE PERPUTHJE ME RREGULLOREN E TEKNIKES SE SIGURIMIT PER PUNE ME LENDE PLASESE NE KARRIERE.**

#### **Sigurimi teknik dhe mbrojtja ne pune gjate shfrytezimit te objektit.**

Gjate ushtrimit te aktivitetit minerar gjate vitit ne vazhdim, subjekti do te mbaje parasysh qe problemet e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune jane me te rendesishmet dhe me te mprehta dhe kerkojne vleresim serioz, duke patur parasysh qe shfrytezimi i tanikeve dhe blloqeve te rezevave te mbetura eshte nje proces teknik dhe teknologji me i veshtire se shfrytezimi i vendburimive te mirefillta.

Para se gjithash ne te gjitha operacionet do te punesohen specialiste me eksperience pune ne nentoke.

Drejtuesi teknik i punimeve para fillimit te punes do te zbatoje rregullat dh normat e percaktuara ne Rregulloren e Teknikes se Sigurimit per Minierat dhe Karierat te hartuara nga Insituti i Teknologjise Nxjerrese dhe Perpunuese te Mineraleve te miratuar me urdher te Ministrit Nr 132 date 0.7 0.4 1999, mbeshtetur ne Ligjin Minerar Shqipetar Nr 10304 date 15.07.2010.

Rregullorje e Teknikes se Sigurimit, nga ana e drejtuesit teknik te punimeve dhe subjektit, do te zbatohet ne çdo proces pune te percaktuar ne plan – organizimin e kryerjes se punimeve te hartuar nga ai dhe te miratuar nga drejtuesit e firmes.

- Plan organizimi i punimeve do te hartohet para fillimit te punimeve
- Plan organizimi i punes do te hartohet nga drejtuesi teknik i punimeve
- Drejtuesi teknik i punimeve ose personi i ngarkuar do te beje kontrollin teknik dhe azhornimin e sakte te punimeve te çdo lloji per te cilat subjekti ka marre license.
- Rradha e kryerjes do te percaktohet hollesisht ne planin e masave tekniko-organizative dhe do te miratohet nga pronari i firmes.
- Ne kete plan tekniko-organizativ masat e teknikes se sigurimit dhe te ajrimit do te zene vendin kryesore.
- Drejtuesi teknik i punimeve do te kryeje instruksione te rregullta mujore e tremujore, ku do te trajtohen tema te veçanta per te gjitha profesionet.
- Punonjesit e ajrimit ose ata qe jane caktuar te merren me te dhe zjarmetaret direkt ose te nenkontratar, do te testohen çdo tremujore kundrejt firmes .
- Kujdes i veçante do te tregohet ne krijimin e kushteve te punes, pastrimit te galerive, kanalizimeve etj.
- Do te zbatohet nje regjim i rrepte ne zbatimin e pasaportave teknike te armatimit, te ringritjes, te hapjes se oxhaçeve dhe te punimeve te shfrytezimit, te hartuara paraprakisht nga drejtuesi teknik I punimeve dhe miratuar nga drejtuesi i subjektit.
- Do te zbatohet me perpikmeri procesi I pregatisje se fitilit ndezes dhe te kontrollit konforme rregullores se teknikes se sigurimit per perdorimin civil te lendeve plasese ne Republiken e Shqiperise(Miratuar me V.K.M Nr.533 date 08.07.2005),nenet 255 dhe 260.

### **Plani i likuidimit te avarive**

Ne vendburimin ne fjale, ( ne te cilin do te zhvillohet veprimtari minerare gjate vitit 2013, ne pergjithesi nuk pritet te ndodhin avari, si per sa i takon shembjes se punimeve horizontale kryesore dhe ne punimet vertikale e te pjerreta te cilat ne pergjithesi jane me armatim te puthitur. Horizontet kryesore (nivelet e transportit dhe ajrimit ) pergjithesisht kalojne neper formacione te qendrueshme. Edhe ne ata vende ku formacionet kane qene me qendrueshmeri te dobet si dhe ne kryqezimet e punimeve , ato ne pergjithesi jane armatosur me lende drusore. Sasia e materialit qe mund te shembet eshte deri ne 30 m<sup>3</sup>. Megjithate si nga pervoja ashtu dhe per vete natyren e minieres mund te ndodhin avari te ndyshme , per menjanimin dhe lekujdimin e te cilave duhen marre masa te menjehereshme per shpëtimin e jetes se njerzve.



### Pasqyra e planit te likujdimit te avarive

Nr	Vendodhja e avarise	Lloji i avarise	Levizja e njerezve	Menyra e likujdimit te avarise
1	Ne te gjitha frontet e punes	Renie e papritur e njerezve ne gazra (helmim nga gazrat ne zona te ndotura)	Personi I helmuar nxirret menjehere ne rrymen e paste rte ajrit, I hapet goja dhe I behet frymarrje artificiale nga goja e I behet shtypja e lehte e gjoksit per te aktivizuar frymemarrjen	Pas shpetimit te jetes se njerezve behet ajrimi intensive I frontit duke perdorur ezhektoret dhe ne raste te vecanta mund te perdore dhe ajri I kompsuar.aktivizimi I frontit behet kur matjet regojne sasine e lejuar te permbajtjes se lendeve te demshme.
2	Horizonti +803	Shembje e mundshme e punimit ne vende me qendrueshmeri te dobet.	Njerezit do te levizin ne drejtim te rrugedaljeve te dyta (punime te pjerrta ose vertikale), qe lidhen direkt me siperfaqen.	Pas shpetimit te njerezve punohet per rehabilitimin e punimit te demtuar duke e kthyer ate ne gjendje te plote pune.
3	Ne frontet e punes gjate hapjes se punimeve minerare apo shfrytezimit	Demtimit punimesh nga renia e blloqeve ose prishja armatimi.	Njerezit levizin me shpejtesine rrugedaljet me te afera te bllokut, per te dale tek rrugdalja kryesore, dhe prej andej dalin ne siperfaqe.	Pas shpetimit te njerezve punohe per rehabilitimit e punimit te demtuar duke e kthyer ate ne gjendje te plote pune.
4	Ne frontin e punes	Shperthimi i mundeshem ujrash n/tokesore.	Njerezit levizin me shpejtesi per ne rrugdaljen e dyte ekzistueseqe lidhet direkt me siperfaqen.	Pritet derisa te ndalohet rrjedhja e ujrave dhe kur cmohet se avaria eshte eliminuar fillon puna.

### Programi i kualifikimit vjetor te punonjesve

Nr	Temat qe do te referohen	Oret	Muaji	Instruktori
1	➤ Njohuri per hapjen e punimeve minerare (minierat metalore)	1	Janar	Drejtuesi Teknik
2	➤ Llojet e shkembinjve dhe te mineraleve ➤ Kategorizimi i tyre sipas fortesise, menytrat e shpimit te birave, paisjet			
3	➤ Njohuri te pergjithshme per lendet pasese e shperthyese. Lendet plasese dhe shperthyese qe perdoren ne miniere, ndarjet e tyre sipas perberjes kimike	2	Shkurt	Drejtuesi Teknik
4	➤ Llojet e kapsolleve, ndertimi dhe perberja e tyre. Menyra e pregatitjes se gypit ndezes.	2	Mars	Drejtuesi Teknik
5	➤ Ç'jane plasjet elektrike, ndertimi i kapsollave elektrike, menyra e lidhjes se tyre ne punimet minerare	3		Drejtuesi Teknik
6	➤ Ç'eshte koalidimi i lendeve eksplozive dhe shperthyese, kapsollave zjarrpercjellese dhe elektrike si dhe kontrolli i fitilit zjarrpercjelles.	2	Prill	Drejtuesi Teknik
7	➤ R.S.T per pergatitjen, mbushjen dhe plasjen si dhe likujdimin e minave te paplasura. Evidentimi i tyre.	2	Maj	Drejtuesi Teknik
8	➤ Transporti i lendes plasese dhe shperthyese, transporti i tyre ne punimet nentokesore sipas RR. S. T.	2		
9	➤ Ajrimi i punimeve minerare gjate avancimit, llojet e gazeve dhe sasia e tyre pas plasjesse minave. Sasia e ajrit te nevojshem	2	Qershor	Drejtuesi Teknik
10	➤ Llojet e punimeve minerare, ndarja e tyre sipas madhesise, afatit te sherbimit, qellimit dhe te hapjes dhe pozivionit hapesinor. Menytrat e hapjes se vendburimeve	2		
11	➤ Armatimi i punimeve minerare, llojet e armatimit, materialet qe perdoren.	1	Korrik	Drejtuesi Teknik
12	➤ Armatimi me lende druri. Llojet e lendes se drurit qe perdoren. Pregatitja dhe vendosja e tyre ne punimet minerare	2		
13	➤ Furnizimi i minierave me ajer te komprimuar, llojet e kompresoreve, ndertimi i linjave te ajrimit	2	Gusht	Drejtuesi Teknik
12	➤ Shpimi i birave, llogaritja e numrit te birave per ballet e punimeve dh konsumit specifik i lendes plasese dhe shperthyese.	2		
13	➤ Llojet e çekiçeve shpues pneumatk, pjeset perberese dhe menyra e lubrifikimit, mirmbajtja e	2	Shtator	Drejtuesi Teknik

	tyre.			
14	➤ Pasaporta e shpim – plasjes e punimeve minerare.	1	Tetor	Drejtuesi Teknik
15	➤ Pasaporta e armatimit te punimeve minerare.	2		
16	➤ Sistemi i shfrytezimit ne miniere (sistemet ne minierat metalifere)	2		
17	➤ Sistemi i shfrytezimit me “galeri nenkati”	2	Nentor	Drejtuesi Teknik
18	➤ Sistemi i shfrytezimit me dhoma e kollona “llave kati”	2		
19	➤ Transporti ne miniere, llojet e transportit dhe mjetet e transportit, ndertimi i vagonave dhe llojet e tyre.	2	Dhjetor	Drejtuesi Teknik
20	➤ Ndertimi i rrugeve te shinave, mjetet qe perdoren dhe kushtet qe duhet te plotesojne.	1		
21	➤ Heqja e ujrave ne miniere, llojet e pompave, furnizimi me energji elektrike.	1		
22	➤ Njohuri per likujdimin e avarive ne miniera	1		

Drejtimi teknik i punimeve per shfrytezimin e mineralit do te behet nga specialist i larte miniere me eksperience ne fushen e shfrytezimit te mineralit te kromit. Regulloret e Tekniques se Sigurimit duhet te respektohen me rigorozitet.

#### 4 PROCESI I VENDIMMARRJES DHE ROLI I VNM-SE NE KETE PROCES

Ne kuadrin e ketij projekti synohet te jepet ne menyre te detajuar vleresimi i ndikimit ne mjedis per objektin minerar qe kerkohet te pajiset me leje mjedisore, ne te cilin pershkruhen ne menyre te hollesishme karakteristikat fizike te projektit, marrja ne konsiderate e alternativave, pershkrimi i karakteristikave te mjedisit qe mund te ndikohet, pershkrimi i ndikimeve te rendesishme te veprimtarise, parashikimi i ndikimeve indirekte, pershkrimi i masave per zbutjen e ketyre ndikimeve dhe permbajtja joteknike e projektit.

Keto toka karakterizohen nga permbajtje mesatare humusi, reaksion nga pak acid ne neutral, kompleks thithes te madh dhe saturim te larte me baza, kryesisht me Ca dhe Mg, horizont iluvial karbonatik, argjilim dhe ngjeshje ne horizontet e mesme te profilit. Formula e profilit eshte A-AB-B-BC-C ose A-AB-BC ose A-AC-C.

Ne te gjithe rajonin perreth vendburimit, tradicionalisht, zhvillohen aktivite ekonomike minerare, gje qe ka ndikuar edhe ne llojshmerine faunistike te pranishme ne te. Ne zone nuk egziston mundesia e stehimit te gjitareve te medhenj te cilet t'a perdorin ate si arela per sigurimin e ushqimit, ndersa formacionet me shkurre sherbejne si zona te pershtatshme per fshehjen dhe kullotjen e zvarranikeve te tille si breshka e zakonshme (Testudo hermani), apo zhapikeve si specia e zhapiu te gjelbert (Lacerta viridis). Lendinat e hapura me bimesi barishtore paraqiten me rendesi per kullotjen e iriqit

Zona ne te cilen do te zhvillohet aktiviteti nuk gezon status te vecante si zone e mbrojtur, pasi flora dhe fauna jane shume pak te zhvilluara. Terreni pergjithesisht eshte shkembor, pothuaj i zhveshur dhe i mbuluar me barishte e shkurre shume te rralla.

Rajoni ne studim pershkohet nga nje rrjet i dendur perrenjsh dhe rrekezash me karakter stinor. Periferia e zones ku ndodhet objekti ka nje shperndarje karakteristike te tyre. Ushqimi i vetem i prurjeve jane rreshjet e shiut dhe debores. Tipar karakteristik i regjimit hidrologjik eshte luhatja e theksuar e niveleve te tyre gjate vitit, e cila lidhet kryesisht me nivelin e reshjeve. Periudha me prurje te shumta shfaqet gjate muajve tetor-maj dhe me prurje te pakta qershor – shtator. Rrjedhja minimale eshte e lidhur me reshjet e pakta dhe avullimin e fuqishem per shkak te temperaturave te larta. Rrjeti hidrografik i perrenjve perben zonen e drenimit edhe per objektin qe do te shfrytezohet.

Sipas klasifikimit klimaterik te vendit tone te bere nga Instituti Meteorologjik i Akademise se Shkencave, zona ne te cilen ndodhet objekti "Zogaj", karakterizohet nga nje dimer i ftohte dhe vere e fresket.

Sipas rajonizimit klimatik te Shqiperise objekti ben pjese ne zonen mesdhetare malore, nenzona mesdhetare malore lindore me klime te ashper.

Faktore ndikues ne formimin e klimes ne kete zone eshte shtrirja ne skajin verilindor te vendit, kushtet e nje relieve kryesisht kodrinor. Temperatura mesatare vjetore eshte 11.4-11.6°, temperaturat mesatare te janarit jane 0.5-1°, kurse ato te korrikut 21°. Vlerat me te larta te temperaturave jane rregjistruar ne Krume (38.6°), ndersa ajo me uleta – 19°.

Ererat kryesisht veriore e verilindore kane shpejtesi mesatare qe luhatet 2.4 m/sek deri 3.3 m/sek dhe ne raste te vecanta deri ne 15 m/sek. Lageshtia mesatare relative e ajrit eshte 40 %.

## **5 METODAT E PERQASJET PER VLERESIMIN**

Çdo aktivitet qe zhvillohet ne mjedis shoqerohet me pasoja dhe ndikime ne mjedis qe jane pjese e atij kompromisi qe shoqeria jone ka zgjedhur per t'u zhvilluar. Megjithate e rendesishme eshte qe te kuptohet natyra e ketyre proceseve, forma e shfaqjes se tyre dhe me analitikisht ndikimet e çdo operacioni te kryer, sidomos mbi burimet natyrore te parinovueshme.

Industria minerare eshte shume e rendesishme ne ekonomin e nje vendi, por ajo shoqerohet edhe me ndikime mjedisore negative te cilat ne disa raste mund te jene te pashmangshme. Shume prej ndikimeve negative mjedisore mund te minimizohen permes nje planifikimi te kujdesshem mjedisor dhe aplikimit te teknikave dhe teknologjise se parandalimit te ndotjeve.

Vleresimi i ndikimeve te mundshme si pasoje e veprimtarise behet duke u nisur nga nje sere faktoresh qe lidhen me natyren e veprimtarise, teknologjine e perdorur, menyren e operimit, sasine e energjise, lendet e para te perdorura dhe mbetjet e gjenerura, te gjitha keto ne kontekstin e mjedisit fizik, biologjik dhe socio-ekonomik.

Kur flasim per shfrytezim te resurseve minerare duhet te marrim ne konsiderate perdorimin e makinerive te renda, te ekspoziveve si dhe zhvendosjen e transportin e sasive te medha te mineralit nga nentoka.

Bazuar ne menyren e propozuar per shfrytezim ndikimet me thelbesore mund dhe duhet te analizohen sipas fazave te veprimtarise, konkretisht,

- ne fazen pergatitore/instalimeve/rikonstruksionit dhe kryerjes se punimeve te reja
- ne fazen e shfrytezimit
- ne fazen e mbylljes, rehabilitimit te objekteve dhe riaftesimit te proceseve natyrore.

Eshte e rendesishme te kuptohet natyra e ketyre proceseve dhe forma e shfaqjes se tyre, direkte ose indirekte, ne menyre qe te percaktohet qarte lloji i ndikimeve:

- Ndikime te kthyeshme ne mjedis
- Ndikime te pakthyeshme ne mjedis

Te dy llojet e ndikimeve mund te minimizohen ne terma relative ku qellimi kryesor eshte mbajtja e tyre brenda siperfaqes se objektit te kerkuar dhe krijimi i kushteve natyrore per te siguruar riaktivizim e proceseve te natyres dhe rigjenerim te ekosistemit.

Per vleresimin e ndikimeve ne mjedis te projektit u ndoqen hapat e meposhtme:

- njohja me projektin dhe teknologjine e tij, menyra e propozuar per shfrytezim,
- njohja me natyren e operacioneve te nevojshme ne mjedis,
- njohja me vlerat natyrore dhe mjedisore te zones dhe siperfaqes,
- historiku i nderveprimit mjedisor te minieres me zonen,
- konsultimi me shume dokumenta e raporte te VNM per veprimtari te njejta.

Subjekti do te kujdeset per administrimin e çdo informacioni qe lidhet me ushtrimin e veprimtarise. Administrimi i te dhenave konsiderohet shume i rendesishem per menyren e operimit te subjektit dhe do te perdoret per te permiresuar eficencen e çdo mase te parashikuar per zbutjen e ndikimeve ne mjedis dhe ne teresi. Per mbajtjen e te dhenave do te perpillohet nje regjister i veçante, fushat e te cilit te mbulojne te gjithë llojin e informacionit te mbledhur qe lidhet me aktivitetin e minieres.

• **VLERAT E GARANCIVE PER VITIN 2015:**

Ne perputhje me percaktimet ne nenin 31 te Ligjit nr. 10304 dt.15.07.2010 " Per sektorin minerar ne Republiken e Shqiperise" sipas programit minimal te punes per vitin 2015 per investimet, prodhimin, dhe mjedisin me poshte po japim garancite perkatese te subjektit: **Garancia financiare për rehabilitimin e mjedisit** Nga shoqeria eshte bere pagesa e garancise se rehabilitimit ne perputhje me tarifat e percaktuara nga A.K.B.N. **Garancia financiare për realizimin e programit minimal të punës** eshte llogaritur ne baze te investimit vjetor per periudhen 1 – vjecare dhe perfaqeson 10% te tij:

**Pergatiti permbledhjen jo teknike**

**"STUDIME PROJEKTIVE MINERARE " sh.p.k.**

<b>Inxh. Miniere-Markshejder:</b>	<b>Halil BULICA</b>
<b>Inxh. Miniere:</b>	<b>Ardian BRAKO</b>
<b>Ekspert Mjedisor :</b>	<b>Hysen DOÇI</b>